

Takim pune i Komisioneres për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me Kreun e Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë

Komisionerja për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, znj. Lefterije Lleshi (Luzi), zhvilloi një takim pune me Kreun e Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë, znj. Giulia Re.



Komisionerja informoi Kreun e Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë, mbi veprimtarinë e institucionit, si dhe mbi risitë e parashikuara në draftligjin “Për nëpunësin civil”, të cilat lidhen drejtpërdrejt me përmirësimin dhe forcimin e procesit të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil. Ajo theksoi rëndësinë e garantimit të një sistemi të qëndrueshëm dhe të bazuar në meritë, në funksion të rritjes së transparencës, profesionalizmit dhe integritetit në administratën publike.

Gjithashtu, Komisionerja nënvizoi nevojën për vijimin e bashkëpunimit institucional dhe për mbështetje të mëtejshme në realizimin e reformave ligjore dhe administrative në vend, veçanërisht në drejtim të:

- forcimit të kapaciteteve institucionale në mbikëqyrjen e administrimit të shërbimit civil;
- zhvillimit dhe aplikimit të metodologjive bashkëkohore të mbikëqyrjes, në përputhje me standardet evropiane të administratës publike;
- organizimit të programeve të trajnimit dhe ngritjes së kapaciteteve për nëpunësit civilë dhe strukturat përgjegjëse;
- shkëmbimit të eksperiencave me institucionet homologe në rajon dhe në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës;
- konsultimit me praktikantët më të mira dhe standardet e zhvilluara në kuadër të jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në çështje që lidhen me administratën publike dhe të drejtat e nëpunësve civilë.



Shefja e Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë, znj. Giulia Re, falënderoi Komisioneren për informacionin e detajuar mbi rolin dhe veprimtarinë e institucionit që ajo drejton dhe shprehu

gatishmërinë për thellimin e bashkëpunimit në të ardhmen. Ajo theksoi mundësinë për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta dhe programeve trajnuese, veçanërisht në fushën e vendimmarrjes administrative, mbrojtjes së të drejtave të nëpunësve civilë, çështjeve të barazisë gjinore dhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në fushën e shërbimit civil.

Takimi u zhvillua në frymën e bashkëpunimit të ndërsjellë, me synim mbështetjen e proceseve për forcimin e mëtejshëm të integritetit, profesionalizmit dhe meritokracisë në administratën publike në Shqipëri.